

AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

“ Vena Konstruksion ” Shpk

Sot më date 27 / 05 / 2024, une i nënshkruari **Blerim Vena** i datëlindjes 05.06.1980, lindur ne Burizane ,Shqipëri dhe banues në Borizane ,

shpreh vullnetin për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë “ **Vena Konstruksion ” sh.p.k.** si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria “ **Vena Konstruksion ” shpk**, nga këtu e mëposhtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e “Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar”, shkurtimisht SHPK.

2. Ortaket themelues

Ortaket themelues te shoqërisë jane :

z. Blerim Vena.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë “**Vena Konstruksion ” sh.p.k.** do të jetë:

- Investitor në ndërtim . Dhenie me qera e ambienteve të banimit dhe shërbimit.
- Import – eksport mallra industrial,ushqimor,bimesh medicinale, farmaceutike,fruta perime. Import -eksport i automjeteve dhe paisjeve energjitike.
- Shitje me shumice dhe pakice te materialeve te ndertimit,artikuj industrial,ushqimore,mobileri,pasticeri,kancelari ,elektroshtepiake.
- Ndërtim i godinave të banimit dhe shërbimit, punime të gjitha llojeve në ndërtim. Ndërtim dhe investitor në hoteleri dhe resorte turistike.

4. Selia e shoqërisë

4.1 Selia e Shoqërisë “ **Vena Konstruksion ” sh.p.k.** do të jetë në adresën: Rruga Zallit, Selite- Tiranë ZK 3292 Numër Pasurie 109/67.

4.2 Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë



Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë 20 (njetzet) vjeçare, e cila fillon nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

Afati i përmendur në pikën 1 të këtij neni mund të shkurtohet apo zgjatet me vendim të ortakeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ky Statut.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare “ **Vena Konstruksion**” sh.p.k. është 100.000 (një qind mije) Lekë.

Pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të **Shoqërisë** bëhet me vendim të **Ortakeve**. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të **Shoqërisë** në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë. Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar bëhet me akt noterial.

7. Ortaket

Ortaket ushtrojnë kompetencat që ligji i jep Asamblesë së Otakëve.

8. Drejtimi dhe Administrimi.

Shoqëria drejtohet nga Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “ **Vena Konstruksion**” sh.p.k. është z.Blerim Vena.

Administratori emërohet me vendim të Ortakeve , për një periudhë jo më shumë se 5 vjet. Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “ **Vena Konstruksion**” sh.p.k. në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njeh ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ajo ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

9. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Themeluesit

Blerim Vena

Blerim Vena